



---

**UNIVERSITETI I TETOVËS**  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

**RAPORT**

**PËR VETEUVALUIMIN E**  
**FAKULTETIT PEDAGOGJIK**  
**PËR VITET AKADEMIKE 2019-2022**

**Tetovë, 2024**

**Fakulteti Pedagogjik-Педагошки факултет-Faculty of Pedagogy**  
Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia  
www.unite.edu.mk – e-mail: pedagogy@unite.edu.mk

## PËRMBAJTJA

|                                                                               |    |
|-------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. QËLIMI I PROCESIT TË VETEEVALUIMIT .....                                   | 4  |
| 2. PËRSHKRIMI FAKULTETIT .....                                                | 5  |
| 2.1. Historiku.....                                                           | 5  |
| 2.2. Misioni .....                                                            | 7  |
| 2.3. Strategjia e zhvillimit .....                                            | 8  |
| 3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT.....                                   | 9  |
| 3.1. Organogrami.....                                                         | 9  |
| 3.2. Programet studimore .....                                                | 10 |
| 4. VEPRIMTARIA MËSIMORE .....                                                 | 13 |
| 5. STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR.....                                  | 17 |
| 5.1. Kuadri mësimor në Fakultetin Pedagogjik .....                            | 19 |
| 5.2. Kuadri mësimor në programin studimor Pedagogji Profesionale .....        | 20 |
| 5.3. Kuadri mësimor në programin studimor Mësim Klasor .....                  | 21 |
| 5.4. Kuadri mësimor në programin studimor Drejtimi Parashkollor.....          | 22 |
| 5.5. Kuadri mësimor në programin studimor Edukim Special dhe Rehabilitim..... | 24 |
| 6. STRUKTURA E STUDENTËVE .....                                               | 25 |
| 6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike .....                   | 25 |
| 6.2. Struktura e studentëve në studimet postdiplomike.....                    | 29 |
| 6.3. Struktura e studentëve në studimet e doktoratës .....                    | 31 |
| 7. ANKETIMI I STUDENTËVE.....                                                 | 33 |
| 8. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJEËMARRJA NË PROJEKTE .....                     | 38 |
| 9. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE .....                                     | 54 |
| 10. SWOT ANALIZA.....                                                         | 56 |
| 11. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....                                         | 58 |

## 1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEUVALUIMIT

Qëllimi i vetëvlerësimit është të identifikohet gjendja momentale e Fakultetit Pedagogjik dhe përfundimet nga i njëjti të shërbejnë si bazë e mbindërtimit të cilësisë së procesit mësimor-shkencor, edhe atë në studimet e ciklit të parë, të dytë dhe atë të tretë. Vlerësimi i brendshëm realizohet nga komisioni për vetëvlerësim i Fakultetit Pedagogjik. Në proces të vlerësimit përfshihen:

- Vlerësimi i programeve studimore në të cilin përfshihen: themelimi, përshkrimi dhe zhvillimi i programeve studimore;
- Struktura e kuadrit mësimor-shkencor;
- Përshkrimi i realizimit të mësimdhënies;
- Vlerësimi i veprimtarisë shkencore të kuadrit mësimor;
- Struktura e studentëve;
- Anketimi i studentëve që vlerësojnë më tepër komponentë;
- Struktura e kuadrit administrativ dhe teknik;
- Hapësirat dhe burimet për realizim të procesit mësimor.

Gjatë realizimit të këtij procesi të vetëvlerësimit nuk është evidentuar ndonjë vështirësi e theksuar. Vlen të theksohet në veçanti mbështetja dhe ndihma e vazhdueshme e ofruar nga të gjitha palët e kyçura në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në realizimin e procesit të vetëvlerësimit, grumbullimin e të dhënave, realizimin e anketave dhe të gjitha aktiviteteteve tjera që ndërlidhen me këtë proces. Për përfundimin e suksesshëm të këtij procesi u tregua si shumë i dobishëm edhe bashkëpunimi dhe mirëkuptimi i treguar nga ana e profesorëve, bashkëpunëtorëve dhe studentëve, të cilët ishin të përfshirë gjatë procesit të vetëvlerësimit në forma nga më të ndryshmet, qoftë si anëtarë të komisionit, si anketues ose të anketuar.

Për të verifikuar se sa janë të arritshme qëllimet e parapa më lart, Fakulteti Pedagogjik në bashkëpunim me Zyrën për Evaluim organizon vlerësim të brendshëm të programeve mësimore.

Qëllimi i vetëvlerësimit është që përmes masave të duhura kërkimore të fitohet një pasqyrë e përgjithshme e cilësisë së punës, progresit dhe arritjeve në të gjitha fushat e Fakultetit, të identifikohen pikat e forta dhe të dobëta, për të cilat do të merreshin masat e duhura për t'i tejkaluar. Pikërisht aktivitetet e tilla do të ndikonin në motivimin e të gjithë pjesëmarrësve në procesin e mësimdhënies, për t'i investuar kapacitetet e tyre dhe për t'i përdorë burimet

ekzistuese për përmirësimin e kushteve dhe standardeve në Fakultet.

Qëllimet kryesore të procesit të vetëvlerësimit janë:

- Të japë një përshkrim të përgjithshëm dhe të saktë të Fakultetit dhe procesit mësimor-shkencor, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve të tjera brenda në Fakultet;
- T'i analizojë pikat e forta dhe të dobëta të Fakultetit, mundësitë dhe pengesat për zhvillim dhe të propozojë masa për përmirësimin e tyre;
- Të sigurojë një bazë solide për realizimin e procesit të vetëvlerësimit dhe akreditimit të programeve studimore të Fakultetit;
- Përcaktimi i treguesve dhe kriterëve të matshme për vlerësimin e cilësisë së procesit shkencor - arsimor.

Realizimi i aktiviteteve dhe rezultatet e arritura janë përcjellë edhe me ca lëshime, por duke konsideruar se veprimtaria mësimore dhe shkencore është një proces dinamik dhe që në vazhdimësi kërkon përmirësime dhe begatim të aktiviteteve që ushtron dhe realizon njësi akademike, prandaj edhe tejkalimi i të gjitha lëshimeve dhe dobësive eventuale nënkupton:

- Rritje të efikasitetit dhe cilësisë në studime;
- Zbatim të metodologjisë-me në qendër studentin;
- Komunikim cilësor, nëpërmes vënies së studentit në pozitë aktive, e në funksion të ngritjes, begatimit dhe cilësisë së dijes;
- Zhvillim të mëtejshëm të punës së pavarur të studentit;
- Ngritje e kalueshmërisë dhe efikasitetit, por e gjithë kjo e bazuar në kriterë dhe standarde, që nënkupton vlerësim objektiv dhe transparent;
- Zbatim konsekuent të sistemit të kredive.

## **2. PËRSHKRIMI FAKULTETIT**

### **2.1. Historiku**

Fakulteti Pedagogjik, përkatësisht programi studimor si degë e pedagogjisë funksionon në kuadër të Universitetit të Tetovës që nga themelimi i Universitetit, më 17 dhjetor 1994,

atëherë kur kuvendi i intelektualëve shqiptarë mori vendim për themelimin e institucionit të arsimit të lartë në gjuhën shqipe, në Republikën e Maqedonisë. Fakulteti Filozofik ishte njëri nga gjashtë fakultetet e para të Universitetit të Tetovës.

Në fillimin e vet, Fakulteti Filozofik kishte dy degë: Histori (39 studentë) dhe Pedagogji (78 studentë). Në vitin akademik 1997/98 dhe 1998/99, ekzistonte Fakulteti Pedagogjik me grupet: Klasor, Parashkollor dhe Profesional. Në periudhën 2001/2002 - 2003/2004, ekzistonte Fakulteti Pedagogjik.

Një periudhë të caktuar kohore, sikurse fakultetet tjera të Universitetit të Tetovës edhe Fakulteti Filozofik veproi si i paregjistruar (pa legalizuar), si rrjedhojë edhe i pafinancuar nga organet shtetërore të Republikës së Maqedonisë. Veprimtaria e Fakultetit kishte të bëjë më tepër me realizimin e mësimi i cili zhvillohej në objekte private të improvizuara në salla mësimi.

Me aprovimin e Ligjit për Themelimin të Universitetit Shtetëror të Tetovës, në vitin 2004, në kuadër të Universitetit në gjuhën shqipe u themeluan pesë fakultete, mes të cilëve edhe Fakulteti i Shkencave Humane dhe Arteve, respektivisht Fakulteti Filozofik u riemërtua si Fakulteti i Shkencave Humane dhe Arteve, në suaza të të cilit funksiononin shtatë programe studimore:

- Histori-Gjeografi,
- Filozofi-Sociologji,
- Pedagogji-Psikologji,
- Art Muzikor,
- Art Figurativ,
- Instituti i Gjuhëve, programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe; dhe
- Instituti i Gjuhëve, programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Angleze.

Senati i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 20.04.2017, solli Vendim me nr. 02-1229/1, për kalimin dhe realizimin e programeve studimore Pedagogji Profesionale dhe Edukim Special dhe Rehabilitim nga Fakulteti Filozofik në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Tetovës. Këshilli i Rektoratit në mbledhjen e mbajtur më 29.11.2017, solli Vendim me nr. 02-4513/1 për bartjen e veprimtarisë së programeve studimore nga fusha e shkencave pedagogjike nga Fakulteti Filozofik në Fakultetin Pedagogjik, respektivisht është bartur veprimtaria e programeve studimore në ciklin e parë të studimeve universitare: Pedagogji

Profesionale dhe Edukim Special dhe Rehabilitim; veprimtaria e programeve studimore në ciklin e dytë të studimeve universitare: Pedagogji-Inovacione Didaktike, Pedagogji-Arsimim Elementar dhe Pedagogji-Menaxhimi në Arsim dhe Veprimtaria e përgatitjes pedagogjike-psikologjike dhe metodike, nga Fakulteti Filozofik në Fakultetin Pedagogjik.

Gjithashtu, mësime dhe bashkëpunëtorët të cilët kanë realizuar mësime në programet studimore Pedagogji Profesionale dhe Edukim Special dhe Rehabilitim, barten nga Fakulteti Filozofik në Fakultetin Pedagogjik. Edhe nëpunësit administrativë të angazhuar në kryerjen e aktiviteteve të punës në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve, barten nga Fakulteti Filozofik në Fakultetin Pedagogjik.

Fakulteti Pedagogjik si njësi organizative akademike në kuadër të Universitetit të Tetovës, veprimtarinë mësimore-shkencore e ushtron në këto programe studimore:

- Pedagogji-Drejtimi Profesional
- Mësim Klasor
- Drejtim Parashkollor
- Edukim Special dhe Rehabilitim

Përpos këtyre programeve studimore, Fakulteti Pedagogjik organizon edhe Rikualifikimin Pedagogjik.

## **2.2. Misioni**

Institucioni i arsimit të lartë, Universiteti, është e arritura kulmore e një shoqërie të organizuar, gjegjësisht është shtylla kryesore e një kombi, në të cilën mbështetet e ardhmja e tij, në garën për krijimin dhe kultivimin e vlerave qytetëruese. Veprimtaria e Fakultetit Pedagogjik, nëpërmjet programeve studimore të ndryshme, prek një numër të caktuar të fushave në sferën e arsimit.

Programet studimore të Fakultetit Pedagogjik janë dizajnuar sipas parimeve të Sistemit të Bolonjës. Misioni i Fakultetit Pedagogjik është edukimi dhe trajnimi i mësuesve dhe profesionistëve të tjerë në fushën e arsimit siç janë: edukatorët e fëmijëve parashkollorë, mësuesit e shkollave fillore dhe pedagogët profesionalë. Synohet që programet studimore t'i përshtaten dinamikës së reformave në sistemin arsimor në vend dhe përshtatjen kundrejt tendencave bashkëkohore në arsim. Ky fakultet synon që studentët të arrijnë: konkurrim në

tregun akademik evropian, profilizim përmes zhvillimit të kompetencave, programe të pranuara në nivel ndërkombëtar dhe mundësi lëvizjeje akademike si dhe krijimin dhe kultivimin e vlerave qytetëruese.

### **2.3. Strategjia e zhvillimit**

Qëllimet kryesore për zhvillimin e Fakultetit Pedagogjik dalin nga raporti për realizimin e planit trevjeçar dhe procesi i vetëvlerësimit. Qëllimet strategjike paraqesin bazë për planifikim dhe përkufizim të qëllimeve të cilët duhet të jenë të matura, të realizueshme, relevante dhe të përcaktuara në kohë (SMART).

Realizimi i aktiviteteve dhe rezultatet e arritura janë përcjellë edhe me disa lëshime, por duke konsideruar se veprimtaria mësimore dhe shkencore është një proces dinamik dhe në vazhdimësi kërkon përmirësime dhe begatim të aktiviteteve që ushtron dhe realizon njësi akademike, tejkalimi i të gjitha lëshimeve dhe dobësive eventuale nënkupton rritje të efikasitetit dhe cilësisë së tyre. Qëllimi kryesor i Fakultetit Pedagogjik është të krijojë gjenerata që do të kenë të zhvilluar kreativitetin dhe mendimin kritik, gjenerata me aftësi ndërmarrëse, të aftë për të vazhduar më tej zhvillimin e tyre profesional duke promovuar mësimin gjatë tërë jetës.

Qëllimet strategjike të Fakultetit Pedagogjik janë:

1. Zhvillim sistematik dhe i vazhdueshëm i cilësisë së punës mësimore dhe hulumtuese-shkencore;
2. Zhvillim i vazhdueshëm i programeve studimore cilësore, në pajtim me kërkesat e tregut të punës, në të gjitha ciklet mësimore;
3. Promovimi i vlerave themelore akademike, siç janë: vlera e përgjithshme e arsimit, kolegjaliteti dhe liria akademike;
4. Përkrahja e veprimtarisë hulumtuese-shkencore në nivel akademik;
5. Botimi i literaturës profesionale;
6. Zhvillimi i vazhdueshëm i përparimit të kushteve të punës dhe pajisjes me teknologji bashkëkohore, përfshirë edhe resurset informatike;
7. Përfshirja e studentëve në punën hulumtuese-shkencore, me theks të veçantë të studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë;
8. Zbulimi në kohë i anomalive në procesin mësimor, si dhe formave tjera të punës së Fakultetit, si dhe marrjen e masave për sigurimin e cilësisë së programeve studimore,

kuadrit arsimor dhe joarsimor, studentëve, bibliotekës, laboratorëve dhe pajisjeve tjera të nevojshme për zhvillim normal të procesit të mësimdhënies dhe veprimtarisë hulumtuese-shkencore;

9. Sigurimi i bashkëpunimit të Fakultetit Pedagogjik me fakultetet tjera pedagogjike në vend, Shqipëri, Kosovë dhe më gjerë për realizimin e projekteve të përbashkëta zhvillimore në disa fusha, ku Fakulteti do të gjejë pikat e interesit;
10. Vendorsja e partneriteteve me institucionet parashkollore dhe ato të arsimit fillor për realizim të praktikës së studentëve.

### **3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT**

#### **3.1. Organogrami**

Procesi mësimor-shkencor në suaza të Fakultetit Pedagogjik realizohet nga 27 mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë me status të rregullt dhe gjysmë orari (part-time). Fakultetit Pedagogjik përbëhet nga: Dekanati i Fakultetit, koordinatoret për ECTS, për ciklin e dytë dhe ciklin e tretë. Në kuadër të Fakultetit Pedagogjik funksionon edhe koordinatori për rikualifikim pedagogjik, i konferencës shkencore dhe ai i projekteve. Në kuadër të Fakultetit Pedagogjik funksionojnë edhe tre shefa të programeve studimore edhe atë: shefi i programit studimor Pedagogji Profesionale, Mësim Klasor dhe Parashkollor dhe Edukim Special dhe Rehabilitim.

Ekipi udhëheqës-drejtues

Ekipi udhëheqës-drejtues përbëhet nga:

- Dekani: Prof.dr.Lulzim Mehmedi,
- Prodekani për arsim: Prof.dr. Besa Havziu,
- Prodekani për shkencë: Prof.dr. Teuta Rasimi Ramadani,
- Sekretari i Fakultetit: Mirvete Shabani
- Kordinatori i ECTS-së: Mr.sc. Afërdita I. Hoxha,
- Kordinatori i ciklit II: Prof.dr. Ardita Ceka,

- Kordinatori i ciklit III: Prof.dr. Jehona Rushidi-Rexhepi,
- Kordinator për rikualifikimin pedagogjik: Prof. dr. Svetlana. P.Gërçarovska,
- Kordinatori i konferencës shkencore: Prodekani për shkencë, prof.dr. Teuta Rasimi Ramadani,
- Kordinatori i projekteve: Ass.mr. Agron Iljazi,
- Shef i programit studimor Pedagogji Profesionale: Prof.dr. Ardita Ceka,
- Shef i programit studimor Mësim Klasor: Doc.Dr.Arbresha Zenki
- Parashkollor: Doc.dr. Gëzim Xhambazi
- Shef i programit studimor ESR: Doc.dr. Arita Agai.

Fakulteti Pedagogjik ka të zgjedhur dhe komision për vlerësim të brendshëm të tij të përbërë nga shtatë anëtarë, prej tyre pesë anëtarë të stafit akademik dhe dy anëtarë nga radhët e studentëve.

### **3.2. Programet studimore**

Në kuadër të Fakultetit Pedagogjik ekzistojnë katër programe studimore për ciklin e parë të studimeve, tre programe studimore për studimet e ciklit të dytë dhe dy programe studimore për ciklin e tretë të studimeve që janë akredituar nga këshilli i akreditimit.

#### ***Programet aktive studimore për studimet e ciklit të parë:***

- Mësim Klasor,
- Pedagogji Profesionale,
- Drejtimi Parashkollor dhe
- Edukim Special dhe Rehabilitim.

#### ***Programet aktive studimore për studimet e ciklit të dytë:***

- Studimet e Magjistraturës: Arsim Elementar, Menaxhimi në Arsim, Inovacione Didaktike, Pedagogji sociale 60, Pedagogji sociale 120, Edukim parashkollor, Autizimi dhe aftësia e kufizuar intelektuale, Logopedia dhe dëmtime në dëgjim, Arsimi inkluziv

- Studime për rikualifikimin e arsimtarëve për përvetësimin e kompetencave të mësuesve për mësuesit e lëndëve.

***Programet aktive studimore për studimet e ciklit të tretë:***

- Strategjia e Zhvillimit të Arsimit dhe
- Strategjia e Zhvillimit të Mësimit.

***Cikli I***

*Tabela 1. Numri i ECTS-ve dhe kualifikimi sipas programeve studimore*

| PROGRAMI                          | S | ECTS | KUALIFIKIMI                                  |
|-----------------------------------|---|------|----------------------------------------------|
| MËSIM KLASOR                      | 8 | 240  | Profesor i diplomuar në mësim klasor         |
| DREJTIMI<br>PARASHKOLLOR          | 8 | 240  | Edukator i diplomuar në mësim parashkollor   |
| PEDAGOGJI<br>PROFESIONALE         | 8 | 240  | Pedagog i diplomuar                          |
| EDUKIM SPECIAL DHE<br>REHABILITIM | 8 | 240  | Edukator special dhe rehabilitor i diplomuar |

***Cikli II***

*Tabela 2. Numri i ECTS-ve dhe kualifikimi sipas drejtimeve studimore*

| PROGRAMI  | DREJTIMI             | S | ECTS | KUALIFIKIMI                                  |
|-----------|----------------------|---|------|----------------------------------------------|
| PEDAGOGJI | Inovacione Didaktike | 2 | 60   | Magjistër i pedagogjisë-inovacione didaktike |
|           | Arsimim Elementar    | 2 | 60   | Magjistër i pedagogjisë-arsimim elementar    |
|           | Menaxhimi në Arsim   | 2 | 60   | Magjistër i pedagogjisë-menaxhimi në arsim   |

|                                               |                                              |   |     |                                                                                                              |
|-----------------------------------------------|----------------------------------------------|---|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                               | Pedagogji sociale                            | 2 | 60  | Magjistër i pedagogjisë-pedagogji sociale                                                                    |
|                                               | Pedagogji sociale                            | 4 | 120 | Magjistër i pedagogjisë-pedagogji sociale                                                                    |
|                                               | Edukim parashkollor                          | 2 | 60  | Magjistër i pedagogjisë -Edukim parashkollor                                                                 |
| <b>EDUKIM<br/>SPECIAL DHE<br/>REHABILITIM</b> | Autizimi dhe aftësia e kufizuar intelektuale | 2 | 60  | <b>MAGJISTËR I EDUKIMIT SPECIAL DHE REHABILITIMIT, DREJTIMI: AUTIZMI DHE AFTËSIA E KUFIZUAR INTELEKTUALE</b> |
|                                               | Logopedia dhe dëmtime në dëgjim              | 2 | 60  | <b>MAGJISTËR I EDUKIMIT SPECIAL DHE REHABILITIMIT, DREJTIMI: LOGOPEDIA DHE DËMTIME NË DËGJIM</b>             |
|                                               | Arsimi inkluziv                              | 2 | 60  | <b>MAGJISTËR I EDUKIMIT SPECIAL DHE REHABILITIMIT, DREJTIMI: ARSIMI INKLUZIV</b>                             |

Tabela 3. Drejtimet dhe numri i studentëve të pranuar në ciklin III për vitin akademik 2020/2021

| PROGRAMI         | DREJTIMI                                | S | ECTS | KUALIFIKIMI                                              | Numri i studentëve të regjistruar në vitin akademik 2020/2021 |
|------------------|-----------------------------------------|---|------|----------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------|
| <b>PEDAGOGJI</b> | Strategjia e zhvillimit të arsimit      | 6 | 180  | Doktor i pedagogjisë-Strategjia për zhvillimin e arsimit | 1                                                             |
|                  | Strategjia e zhvillimit të mësimdhënies | 6 | 180  | Doktor i pedagogjisë-Strategjia për zhvillimin e mësimin | 2                                                             |

Tabela 4. Numri i ECTS-ve dhe kualifikimi sipas drejtimeve studimore

| PROGRAMI         | DREJTIMI                           | S | ECTS | KUALIFIKIMI                                              |
|------------------|------------------------------------|---|------|----------------------------------------------------------|
| <b>PEDAGOGJI</b> | Strategjia e zhvillimit të arsimit | 6 | 180  | Doktor i pedagogjisë-Strategjia për zhvillimin e arsimit |

|  |                                         |   |     |                                                          |
|--|-----------------------------------------|---|-----|----------------------------------------------------------|
|  | Strategjia e zhvillimit të mësimdhënies | 6 | 180 | Doktor i pedagogjisë-Strategjia për zhvillimin e mësimin |
|--|-----------------------------------------|---|-----|----------------------------------------------------------|

#### 4. VEPRIMTARIA MËSIMORE

Programet studimore të ciklit të parë të Fakultetit Pedagogjik për Mësimin Klasor dhe Pedagogji Profesionale janë dizajnuar sipas kriterëve të Sistemit të Bolonjës të akredituara në vitin 2012, për Drejtimin Parashkollor në vitin 2015, kurse për Edukim Special dhe Rehabilitim në vitin 2013. Në kuadër të Fakultetit Pedagogjik, janë të akredituara edhe studimet e ciklit të dytë dhe të tretë. Në të gjitha programet studimore të Fakultetit Pedagogjik, në studimet bachelor, studimet zgjasin 4 (katër) vjet, ndërsa studentët gjithsej grumbullojnë 240 (ECTS) kredi. Sa i përket ciklit të dytë, studentët grumbullojnë 60 (ECTS) dhe 180 (ECTS) në ciklin e tretë.

Programet studimore të Fakultetit Pedagogjik funksionojnë sipas principit të Deklaratës së Bolonjës dhe në pajtim me Ligjin për Arsim të Lartë dhe Statutin e USHT-së, gjegjësisht, kreditë janë të shpërndara sipas ngarkesës së lëndëve për realizim nga ana e studentëve. Si rezultat, në çdo semestër studentët kanë mundësi të ndjekin lëndë obligative, zgjedhore dhe opcionale të cilat janë të shpërndara në një vit akademik sipas proporcionit: lëndët obligative 60%, lëndët zgjedhore 30%, dhe lëndët opcionale 10%. Lëndët realizohen nëpërmjet orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve. Secila lëndë mund të ketë së paku 2 kredi deri në më së shumti 7 kredi, ndërsa mundësia për regjistrimin e semestrit ka pësuar ndryshime nga viti akademik në tjetrin, në bazë të vendimit të Këshillit të Fakultetit. Syllabuset e lëndëve janë të krijuara ashtu që synojnë studentët të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi të cilat mund t'i implementojnë në tregun e punës, respektivisht pjesa teorike e lëndëve është në përputhshmëri me realizimin e pjesës praktike.

Për secilin program studimor, lëndët janë të dizajnuara në atë formë që mundësohet aplikimi i metodave të ndryshme pedagogjike të ligjërimit, gjegjësisht ligjërata interaktive dhe debate; mësim në laboratorë dhe teren, mësim nëpërmjet TI-së duke përgatitur video inçizime studentët nga puna praktike me nxënësit; realizim i mësimin praktik nëpër shkolla dhe

institucione me të cilat është nënshkruar marrëveshje paraprake bashkëpunimi. Sa i përket praktikave të lëndëve, studentët e Fakultetit Pedagogjik (studentët e drejtimit Mësimit Klasor, Profesional dhe Parashkollor) praktikën e kanë realizuar kryesisht nëpër institucionet parashkollore dhe shkollat fillore të komunës së Tetovës. Gjatë realizimit të praktikave studentët kanë qenë nën vëzhgim permanent të profesorëve dhe asistentëve të lëndëve përkatëse. Ndërsa, studentët e programit studimor Edukim Special dhe Rehabilitim, praktikat e tyre i realizojnë si në institucionet vendore ashtu edhe në ato jashtë vendit (shiko tabelen 4.1).

Në të gjitha programet studimore, në afatet e parapara të semestrave përkatës realizohen kolokuiumet për çdo lëndë, përfshirë këtu edhe kolokuiume praktike. Programet studimore janë të orientuara ndaj përshtatjes së dinamikës së reformave vendore dhe ndërkombëtare të arsimit dhe për këtë arsye Fakulteti Pedagogjik ka për qëllim:

- profilizim të studentëve nëpërmjet zhvillimit të kompetencave;
- përgatitje të studentëve që të jenë konkurrentë në tregun e punës;
- programe studimore të pranura në nivel ndërkombëtar;
- ofrim të mundësisë për mobilitet akademik.

Si indikatorë për sukses në nivel të mësimit –mësimdhënies, janë marrë syllabuset si indikatorë dhe përputhshmëria e tyre me literaturën, me përmbajtjen dhe realizimin e tyre, nëpërmes të gjitha formave të mundshme dhe syllabuset si indikatorë që shprehin kompetencat profesionale të studentëve, pas mbarimit të çdo kursi lëndor.

*Tabela 4.1. Institucionet ku studentët e ESR i realizojnë praktikat*

|                                                                                    |       | 0 = Aspak   1= Pjesërisht   2= Plotësisht   (për çdo institucion të shënuar, për çdo indikator) |                                                    |                                       |                                                                  |                                                                               |
|------------------------------------------------------------------------------------|-------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------|------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------|
| Emri i institucionit/ kompanisë/ OJQ (shëno fillimisht ata me të cilat bashkëpunon | Lloji | Është i rëndësishëm për bashkëpunim me programin                                                | Kontribuon në realizimin e praktikës së studentëve | Burim i vendit të punës për studentët | Përfshin kompetencat kryesore të asaj që ofron programi studimor | (Shëno edhe emra të tjerë që vlerësoni se duhet pasur parasysh në të ardhmen) |

|                                                                                      |           |   |   |   |   |                                                                                           |
|--------------------------------------------------------------------------------------|-----------|---|---|---|---|-------------------------------------------------------------------------------------------|
| programi dhe<br>më pas ata që                                                        |           |   |   |   |   |                                                                                           |
| vlerësoni se<br>mund të ketë<br>bashkëpunim)                                         |           |   |   |   |   |                                                                                           |
| Qendra<br>Burimore për<br>Mësim dhe<br>Këshillim<br>"Nënë Tereza"<br>– Prizren       | Shtetëror | 2 | 2 | 2 | 2 | DUCOR<br>„Partenie<br>Zogravski,, –<br>Shkup                                              |
| SH.F.V.<br>"Idnina" –<br>Shkup                                                       | Shtetëror | 2 | 2 | 2 | 2 | Reparti për<br>audiologji<br>"8<br>Septemvri" –<br>Shkup                                  |
| SH.F.K. "25<br>Maji" – Shkup                                                         | Shtetëror | 2 | 2 | 2 | 2 | SUGS<br>„Dimitar<br>Vlahov,, –<br>Shkup                                                   |
| IPSH – Enti për<br>rehabilitim të<br>dëgjimit, të të<br>folurit dhe zërit<br>- Shkup | Shtetëror | 2 | 2 | 2 | 2 | Enti për<br>shëndetin<br>mendor të<br>fëmijëve<br>dhe të<br>rinjve<br>–Mladost -<br>Shkup |

|                                                                                                          |           |   |   |   |   |                                                                                                            |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|---|---|---|---|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Qendra Ditore<br>– Tetovë                                                                                | Shtetëror | 2 | 2 | 2 | 2 | Shoqata për<br>stimulim të<br>hershëm,<br>zhvillim dhe<br>lojë te<br>fëmijët<br>—Kreativa<br>Istok - Shkup |
| SH.F. "Liria" –<br>Tetovë                                                                                | Shtetëror | 2 | 2 | 2 | 2 | /                                                                                                          |
| SH.F. "Brastvo<br>Migjeni" –<br>Tetovë                                                                   | Shtetëror | 2 | 2 | 2 | 2 |                                                                                                            |
| Shkolla speciale<br>për fëmijë të<br>verbër dhe<br>dëmtime në të<br>parë "Dr<br>Xheladin Deda"<br>– Pejë | Shtetëror | 2 | 2 | 2 | 2 | /                                                                                                          |
| DURDMOV<br>„Naum<br>Ohridski,, –<br>Shkup                                                                | Shtetëror | 2 | 2 | 2 | 2 |                                                                                                            |

|                                                                                                    |           |   |   |   |   |   |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|---|---|---|---|---|
| Topansko Pole –<br>Enti për<br>rehabilitimin e<br>fëmijëve dhe të<br>rinjve - Shkup                | Shtetëror | 2 | 2 | 2 | 2 | / |
| IP Enti special –<br>Demir Kapi                                                                    | Shtetëror | 2 | 2 | 2 | 2 | / |
| Shoqata për<br>fëmijë me<br>nevoja të<br>veçanta " Dua<br>ylberin" –<br>Shkup                      | OJQ       | 2 | 2 | 2 | 2 | / |
| Qendra<br>speciale për<br>trajtimin e<br>fëmijëve me<br>nevoja të<br>veçanta "Bota<br>ime" – Shkup | OJQ       | / | / | / | / | / |

## 5. STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR

Në realizimin e procesit mësimor, gjatë periudhës akademike 2019/20, 2020/21, 2021/22, gjatë viteve të ndryshme akademike kanë ndodhur ndryshime në bazë të vitit akademik.

Viti akademik **2019/2020** ishte viti kur u realizuan disa ndryshime me vende të reja mes mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve dhe gjatë këtij viti gjithsej në mësimdhënie ishin të kyçur 12 mësimdhënës të rregullt, edhe atë 5 meshkuj dhe 7 femra, gjegjësisht në bazë të thirrjes: një profesor ordinar, 1 profesor inordinar dhe 10 docentë. Sa i përket profesorëve të angazhuar,

gjithsej kanë qenë 4, 3 meshkuj dhe 1 femër, respektivisht, 2 docentë dhe 2 doktorë shkence.

Nëse i referohemi tabelës së bashkëpunëtorëve, atëherë mund të shihet se mësimi është realizuar nga 7 bashkëpunëtorë të rregullt, 5 asistentë magjistra dhe 2 asistentë të rinj, prej tyre 6 femra dhe 1 mashkull. Ndërsa, si bashkëpunëtorë të angazhuar për nevojat e realizimit të mësimi (kuptohet që kanë qenë më të mëdha) kanë qenë të angazhuar gjithsej 8 bashkëpunëtorë, prej tyre 7 femra dhe 1 mashkull, gjegjësisht 5 asistentë magjistra dhe 3 demonstratorë.

Duke filluar nga viti i parë, kur edhe u promovua si Fakultet i veçantë Fakulteti Pedagogjik, **2020/2021**, kanë qenë të angazhuar gjithsej 23 profesorë, mësimdhënës të rregullt, të cilët u transferuan nga Fakulteti Filozofik. Prej tyre 1 ishte me thirrje mësimore ordinar, 6 inordinarë dhe 14 docentë, ndërsa sa i përket gjinisë 3 meshkuj dhe 17 femra. Për nevojat e realizimit të suksesshëm të mësimdhënies, janë angazhuar part-time edhe 14 mësimdhënës, prej të cilëve 1 me thirrje ordinar, 1 me thirrje inordinar, 1 docent dhe 4 me thirrje shkencore doktor, ndërsa sa i përket gjinisë 4 meshkuj dhe 3 femra. Prej bashkëpunëtorëve, të rregullt kanë qenë 6, prej tyre 1 mashkull dhe 5 femra, ndërsa sipas thirrjes 4 asistentë magjistra dhe 2 asistentë të rinj, ndërsa të jashtëm kanë qenë të angazhuar 10 bashkëpunëtorë, 3 femra dhe 7 meshkuj, gjegjësisht 4 asistentë magjistra dhe 6 demonstratorë.

Në vitin akademik **2021/2022**, në Fakultetin Pedagogjik mësimi u realizua nga gjithsej 20 mësimdhënës, të cilët me rizgjedhjen në thirrje akademike e ndryshuan proporcionin nga viti paraprak, gjegjësisht prej tyre 1 ka qenë me thirrje ordinar, 9 me thirrje inordinarë dhe 8 me thirrje docentë, dhe 2 asistentë, ndërsa sa i përket gjinisë 4 meshkuj dhe 12 femra, si dhe gjithashtu janë angazhuar edhe 18 mësimdhënës part-time, 3 meshkuj dhe 3 femra, gjegjësisht 1 me thirrje ordinar, 1 inordinar dhe 4 doktorë shkence. Sa i përket bashkëpunëtorëve, në këtë vit akademik kanë qenë të angazhuar 5 bashkëpunëtorë kanë qenë me status të rregullt, prej tyre 2 meshkuj dhe 3 femra, gjegjësisht 4 asistentë magjistër dhe 1 asistent i ri, ndërsa prej bashkëpunëtorëve të jashtëm 14 angazhime, 4 meshkuj dhe 10 femra, gjegjësisht 7 asistentë magjistra dhe 7 demonstratorë.

Nëse llogaritet raporti i kuadrit akademik të rregullt me ç'rast gjithsej janë 20 mësimdhënës profesorë, kurse numri i përgjithshëm i studentëve është 710, atëherë mund të konstatojmë se çdo profesori i takon të punojë me 25.5 studentë, kurse çdo bashkëpunëtori, respektivisht asistenti me 41,7 studentë, që rrjedhimisht na mundëson të konkludojmë se ka trend të rritjes së numrit të mësimdhënësve

## 5.1. Kuadri mësimor në Fakultetin Pedagogjik

Tabela 5. Struktura e mësimdhënësve në vitet akademike 2019-2022

| Të rregullt | 2019/2020 |   | 2020/2021 |   | 2021/2022 |    | Me kontratë | 2019/2020 |   | 2020/2021 |   | 2021/2022 |    |
|-------------|-----------|---|-----------|---|-----------|----|-------------|-----------|---|-----------|---|-----------|----|
|             | M         | F | M         | F | M         | F  |             | M         | F | M         | F | M         | F  |
| Ordinar     | 1         | / | 1         | / | /         | 1  | Ordinar     | /         | / | 1         | / | 1         | /  |
| Inordinar   | /         | 1 | 2         | 4 | 2         | 8  | Inordinar   | /         | / | /         | / | /         | /  |
| Docent      | 4         | 6 | 14        | 2 | 1         | 7  | Docent      | /         | / | 1         | / | /         | /  |
| Mr          | 1         | 1 | 1         | 1 | 1         | 1  | Mr. Sc      | 1         | 1 | 1         | 4 | 2         | 15 |
| Gjithsej    | 5         | 7 | 17        | 7 | 4         | 17 | Gjithsej    | 3         | 1 | 4         | 3 | 3         | 15 |

Tabela 6. Struktura e bashkëpunëtorëve në vitet akademike 2019-2022

| Të rregullt   | 2019/2020 |   | 2020/2021 |   | 2021/2022 |   | Me kontratë   | 2019/2020 |    | 2020/2021 |    | 2021/2022 |    |
|---------------|-----------|---|-----------|---|-----------|---|---------------|-----------|----|-----------|----|-----------|----|
|               | M         | F | M         | F | M         | F |               | M         | F  | M         | F  | M         | F  |
| Asistent      | 1         | 1 | 1         | 1 | 1         | 1 | Asistent      | 1         | 5  | 1         | 5  | 1         | 5  |
| Asistent i ri | /         | / | /         | / | /         | / | Asistent i ri | 1         | 6  | 1         | 6  | 1         | 6  |
| Demonstrator  | /         | / | /         | / | /         | / | Demonstrator  | /         | /  | /         | /  | /         | /  |
| Gjithsej      | 1         | 1 | 1         | 1 | 1         | 1 |               | 2         | 11 | 2         | 11 | 2         | 11 |

Ekipimi ynë si Fakultet është bërë në nëntor të vitit 2017, mirëpo akoma ka mungesë të bashkëpunëtorëve të rregullt në programin studimor të Pedagogjisë, si dhe dukshëm mungesë të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve të rregullt në programin studimor të Edukimit Special dhe

Rehabilitimit.

## 5.2. Kuadri mësimor në programin studimor Pedagogji Profesionale

Sa i përket procesit të mësimdhënies, krijuam tabela për të qartësuar se në cilin program mësimor, cili mësimdhënës me çfarë thirrje ka realizuar mësimin. Duke u bazuar në tabelën e mëposhtme, mund të shihet qartë se në programin studimor Pedagogji Profesionale, në vitin akademik **2019/2020**, kanë qenë të rregullt gjithsej 8 mësimdhënës, 3 meshkuj dhe 6 femra, 1 me thirrje ordinar, 4 me thirrje inordinarë dhe 4 docentë, ndërsa të angazhuar me kontratë nuk ka pasur. Sa u përket bashkëpunëtorëve, të rregullt kanë qenë 4, 1 mashkull dhe 3 femra, prej tyre 2 me thirrje asistentë magjistër dhe 2 me thirrje asistent i ri, ndërsa bashkëpunëtorë me kontratë nuk ka pasur.

Në vitin e ardhshëm akademik **2020/2021**, nuk ka ndryshim drastik te mësimdhënësit e rregullt, vetëm riorganizim sipas thirrjes mësimore, gjegjësisht nga gjithsej 9 mësimdhënës të rregullt, 4 ka qenë inordinarë, 2 ordinarë dhe 4 docentë, ndërsa sipas gjinisë 3 meshkuj dhe 6 femra. Gjithashtu në këtë vit nuk ka pasur të angazhuar mësimdhënës me kontratë. Sa i përket bashkëpunëtorëve, gjithsej kanë qenë: 3 bashkëpunëtorë, 2 asistentë të rinj dhe 1 asistent magjistër, gjegjësisht 2 femra dhe një mashkull, ndërsa bashkëpunëtorë të jashtëm nuk ka pasur.

Në vitin akademik **2021/2022** numri i mësimdhënësve të rregullt ka qenë i njëjtë, domethënë nga gjithsej 9 mësimdhënës të rregullt (7 femra dhe 2 meshkuj), 1 ka qenë ordinar, 6 kanë marrë thirrjen inordinarë, dhe 2 docentë dhe nuk ka pasur mësimdhënës të angazhuar me kontratë. Sa i përket bashkëpunëtorëve, në procesin mësimor ka qenë e rregullt vetëm 1 asistente magjistër femër dhe 1 asistente magjistër femër me kontratë.

Tabela 7. Struktura e mësimdhënësve në vitet akademike 2019-2022

| Të rregullt      | 2019/2020 |   | 2020/2021 |   | 2021/2022 |   | Me kontratë      | 2019/2020 |   | 2020/2021 |   | 2021/2022 |   |
|------------------|-----------|---|-----------|---|-----------|---|------------------|-----------|---|-----------|---|-----------|---|
|                  | M         | F | M         | F | M         | F |                  | M         | F | M         | F | M         | F |
| <b>Ordinar</b>   | 1         | / | 1         | / | /         | / | <b>Ordinar</b>   | /         | / | /         | / | /         | / |
| <b>Inordinar</b> | /         | 1 | /         | 4 | /         | 6 | <b>Inordinar</b> | /         | / | /         | / | /         | / |

|                 |   |   |   |   |   |   |                 |   |   |   |   |   |   |
|-----------------|---|---|---|---|---|---|-----------------|---|---|---|---|---|---|
| <b>Docent</b>   | 2 | 4 | / | 4 | / | 2 | <b>Docent</b>   | / | / | / | / | / | / |
| /               | / | / | / | / | / | / | <b>Dr.sc</b>    | / | / | / | / | / | / |
| <b>Gjithsej</b> | 3 | 5 | 1 | 8 | 0 | 8 | <b>Gjithsej</b> | / | / | / | / | / | / |

*Tabela 8. Struktura e bashkëpunëtorëve në vitet akademike 2019-2022*

| <b>Të rregullt</b>   | <b>2019/2020</b> |          | <b>2020/2021</b> |          | <b>2021/2022</b> |          | <b>Me kontratë</b>   | <b>2019/2020</b> |          | <b>2020/2021</b> |          | <b>2021/2022</b> |          |
|----------------------|------------------|----------|------------------|----------|------------------|----------|----------------------|------------------|----------|------------------|----------|------------------|----------|
|                      | <b>M</b>         | <b>F</b> | <b>M</b>         | <b>F</b> | <b>M</b>         | <b>F</b> |                      | <b>M</b>         | <b>F</b> | <b>M</b>         | <b>F</b> | <b>M</b>         | <b>F</b> |
| <b>Asistent</b>      | /                | 2        | /                | 1        | /                | 1        | <b>Asistent</b>      | /                | /        | /                | /        | /                | 1        |
| <b>Asistent i ri</b> | 1                | 1        | 1                | 1        | /                | /        | <b>Asistent i ri</b> | /                | /        | /                | /        | /                | /        |
| <b>Demonstrator</b>  | /                | /        | /                | /        | /                | /        | <b>Demonstrator</b>  | /                | /        | /                | /        | /                | /        |
| <b>Gjithsej</b>      | 1                | 3        | 1                | 2        | /                | 1        |                      | /                | /        | /                | /        | /                | 1        |

### 5.3. Kuadri mësimor në programin studimor Mësim Klasor

Në programin mësimor Mësim Klasor, në vitin akademik **2019/2020** procesi mësimor është zhvilluar nga gjithsej dy mësimdhënës me thirrje docent të gjinisë femërore dhe kanë qenë të angazhuar 1 docent dhe 1 doktor shkence të gjinisë mashkullore. Sa u përket bashkëpunëtorëve, në këtë vit akademik ka qenë e rregullt vetëm 1 femër asistente magjistër dhe i angazhuar 1 mashkull demonstrator me kontratë.

